



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 1726/11 Prot.

Tiranë, më 10.07.2025

VENDIM

Nr. 143, Datë 27.06.2025

“PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS SË KANDIDATES PËR MAGJISTRAT PROKUROR, E CILA MUND TË DIPLOMOHET NGA SHKOLLA E MAGJISTRATURËS NË VITIN 2025, ZNJ. MALBORA DINAJ”

Mbështetur në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 32 dhe 35, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 159 dhe 189 pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Vendimin nr. 171, datë 29.09.2019, “Për miratimin e “Rregullores për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale sipas Relacionit nr. 1726, datë 17.06.2025, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatës për magjistrat prokuror, e cila mund të diplomohet nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2025, znj. Malbora Dinaj.
2. Lejimin e kandidatës Malbora Dinaj, të vijojë me procedurat e mëtejshme për emërimin e saj si prokuror.
3. Të njoftohet për këtë vendim Shkolla e Magjistraturës dhe znj. Malbora Dinaj.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 27.06.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji



ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Arta Mandro




ANËTAR
Ledina Riza



ANËTAR
Moisi Duda



ANËTAR
Olger Eminaj



ANËTAR
Erind Merkuri



KOPJE WEB